

K O N T R A T E

Per krijimin e shoqerise tregtare
me pergjegjesi te kufizuar

" G E C I "

1. PALET.

Ne kuptimin e kesaj kontrate per krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e cila qe ketu dhe me pas referohet si shoqeri pale eshte :

1. Pame Geci, i biri i Alise dhe Razes, i dtlindjes
2.3.1961, lindur ne Tropoje dhe banues ne Laç,
Lagjen Nr.4, pallati 125, shkalla, e 1, apartamenti
14 ne qytetin e Lapid.

2. CELLIMI.

2.1 Cellimi i kesaj kontrate eshte krijimi i shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar. Kjo ~~shoqerise~~ do te kete seline e saj ne qytetin e Lapid dhe do te quhet " GECI ".

2.2 Objekti i veprimtarise se shoqerise percaktohet ne nenin 2 te statutit te shoqerise qe i bashkelidhet kesaj kontrate.

3. DATA EFEKTIVE.

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga dita, kur pasi te jete firmosur nga palet, mbi bazen e saj, te statutit dhe kerkeses, te jete plotesuar e gjitha procedura ligjore dhe te jete bere regjistrimi i shoqerise ne regjistrin tregtare te Gjykates se rrethit Tirane dhe te jete fituar zotesia per te vepruar si person juridik.

4. AFATI.

4.1 Kjo kontrate sherben per nje afat prej 15 vjetesh. Ne perfundim te ketij afati pala mund te zgjase kontraten ose te lidhe nje kontrate te re.

4.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe para ketij afati sipas menyres dhe kushteve te parashikuara ne nenin 12 te statutit.

R Geci

4.3 Nese shoqeria do te mbaroje veprimtarine e saj, pasurine e saj e administron themeluesi.

5. KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE.

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj mbi bazen e kontributit te themeluesit te saj.

Vlera e kapitalit themeltare do te jete 1000000 leke.

6. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALSEVE.

Palaa kane te drejte dhe detyrim per te marre pjese ne administrimin e shoqerise, per te siguruar fitime nga veprimtaria e saj dhe per tu informuar ne cdo kohe per gjendjen ekonomiko-financiare te saj. Te drejtat, detyrimet dhe kompetencat konkrete jane percaktuar ne statutin e shoqerise.

7. JURIDIKSIONI.

Çdo mosmarrveshje qe nuk mund te zgjidhet me pajtim, i referohet per shqyrtim Gjykatës së Rrethit Lap.

Shoqeria duke qene person juridik i ligjshem sipas ligjeve te Republikës së Shqipërisë, e rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me kete kontrate, statutin dhe legjislacionin ne fuqi te Republikës së Shqipërisë.

Tirane, me ____ . 3. 1994

P A L A

Rame Geci

Rame

Republika e Shqipërisë

Ministria e Drejtësisë

" N O T E R I A "

Nr. _____

Tirane, me ____ . 3. 1994

V E R T E T I M

Vertetohet se sot u paraqit para meje noterit ne zyren e noterise Rame Geci i biri i Alise dhe Razes, i dtlindjes 2.3.1961, lindur ne Tropojes dhe banues ne qytetin e Lacit per identitetin e te cilit u sigurova me ane te leter-njoftimit qe me paraqiti. Para meje me vullnet te lire e firmosi kete kontrate.

N O T E R I

S T A T U T I
I shoqerise tregtare
" G E C I "

1. HYPJE

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar që këtu dhe me pas referohet si shoqëri, krijohet mbi bazën e inisiativës dhe kapitalit të :

1. Ram Gecit, i biri i Aliut dhe Bazes, i dtlindjes 2.3.1961, lindur në Tropojë dhe banor në qytetin Laç, Lagjen Nr. 4, pallati 125, shkalla 1, apartamenti 14 Laç .

1.2 Shoqëria krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me normat e këtij statuti, kontratës dhe legjisllacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

1.3 Kjo shoqëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themelues.

2. OBJEKTI.

2.1 Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

Importi dhe eksporti dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i të gjitha llojeve të mallrave, duke përfshirë ato ushqimore, industriale, elektroshtetike, të konsumit të gjërë, karburantëve, lëndëve të para, udhëtimet turistike brenda dhe jashtë shtetit etj.

2.2 Kryerja e investimeve të ndryshme në sektorët e ndërtimit, në rrugë, autostrada, trase, projektim dhe investime të ndryshme në to, apartamente banimi, objekte turistike, vepra ujtesë, materiale inerte, transportit hekurudhorë, rrugore dhe detare, industrisë së lehtë, ushqimore dhe ato të rende, tregtisë, turizmit, hotelerisë, minierave, peshkimit, bujqësisë, pujeve, blegtorisë etj.

2.3 Ndërtimi dhe shfrytëzimi i pikave të shpërndarjes së karburantëve dhe serviseve e parkingeve për automjete.

Rani.

- 2.4. Dhenia e konsulences ne marketing dhe ushtrimi i veprimtarise ne sferen e finances, kambizmit valutore dhe ne ate bankare.
3. EMPI, SELIA, TERRITORI.
- 3.1. Kjo shoqeri do te qubet " G E C I ".
Shoqeria do te fitoje personalitetin juridik nga data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës.
- 3.2. Shoqeria do ta ketë qendren e saj ne qytetin e Lagit. Selia e shoqerise do te jete Lagja Nr.4, pallati 125, shkallat 1, apartamenti 14 Laq.
- 3.3. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise.
- 3.4. Ajo mund te krijojë degë ose perfagesi edhe ne rrate te tjera te Shqiperise ose jashte saj.
4. KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE.
- 4.1. Kapitali themeltare i shoqerise perbehet nga kontributi i te themeluesit te saj ne shumën 1000000 leke.
- 4.2. Kapitali themeltare do te depozitohet ne nje banke te qytetit te Lagit para fillimit te aktivitetit te shoqerise.
- 4.3. Kapitali themeltare mund te shtohet ose pakesohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne miratim te administratorit si dhe ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.
- 4.4. Kapitali themeltare mund te transferohet jashte shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 4.5. Kapitali themeltare eshte lirisht i transferueshem ne rruge trashegimie. Bashkeshortet, pararendesit dhe pasardhesit, mund te behen ortakë, nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltare me miratim te administratorit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 4.6. Kapitali themeltare mund te shtohet edhe me pranimin e ortakëve te tjere ne miratim te administratorit.

Roci.

5. FONDET E SHOQERISE.

5.1 Shqogeria percakton fondet e meposhteme :

1. Fondin qarkullues.
2. Fondin rezerve.
3. Fonde te tjera, te cilat mund te jene te nevojshme per realizimin e veprimitarise se saj.

5.2 Masa e secilit fond dhe merrga e perodirimit te tij, percaktohen me vendim te organit drejtues te tij.

6. ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE.

6.1 Organi me i larte drejtues i shoqerise eshte administratori, qe eshte dhe themelues i saj.

6.2 Administratorit miraton politiken afariste dhe percakton fushat konkrete te veprimitarise se saj.

6.3 Miraton emerimin dhe shkakrimin e eksperteve kontabel.

6.4 Shqyrton bilancin vjetore dhe percakton kuotat e fondeve te ndryshme si dhe fitimin se ofare do te behet me te.

6.5 Vendos per krijimin e degëve ose perfaqesive si dhe miraton krijimin e ndermarrjeve apo shoqerive te perbashketa me persona te tjere fizike e juridike.

6.6 Vendos per marrjen e kredive, dhe shnderrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te llojeve te tjera.

6.7 Miraton ose realizon qimet e shitjes dhe te sherbimeve.

6.8 Miraton pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.

6.9 Miraton rregulloret per sektore te vecante te veprimitarise se shoqerise

6.10 Kujdeset per funksionimin normal e te perditchme te aktivitetit ekonomiko-financiare te shoqerise ose te pjeseve te vecanta te aktivitetit te saj.

Ujket probleme te shoqerise me organe te ndryshme shtetere ose private.

veton oferta dhe pregatit kontrata per realizimin e veprimitarise.

RGeri.

7. NDARJA E FITIMEVE.

- 7.1 Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve etj, administratorit i mbetet fitimi neto.
- 7.2 Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltare si dhe per shtimin e fondeve te shoqerise te percaktuara ne kete statut.
- 7.3 Fitimi neto mund te perdoret edhe per qellime te tjera.

8. KOHZGJATJE E SHOQERISE.

Kjo shoqeri krijohet per nje afat prej 15 vjetesh.

9. MENYRA E PEFACESIMIT.

Shoqeria perfagesohet nga administratori i saj ne te gjitha marredhenjet e ndryshme juridiko-civile. Ajo mund te perfagesohet edhe nga ndonje person tjeter i paisur ne prokure te posaqme nga administratorit.

10. MARREDHENJET E PUNESIMIT.

Çdo person do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e marredhenjes se punes (kontrates) te lidhur ndermjet tij dhe administratorit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

11. PERGJEGJESI E PUNONJESVE DHE KONFIDENCIALITETI.

Çdo person i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e detyres. Ai eshte i detyruar te permbushë detyrimet qe rrjedhin nga kontrata e punes si dhe vendimet e organeve drejtuese. Ai eshte gjithashtu i detyruar te ruaje karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informacionit, te pervojës së shkëmbyer si dhe te cdo materiali konfidencial.

12. MBARIMI I SHOQERISE.

- 12.1 Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit drejtues te saj, ne rast se aktiviteti nuk rezulton fitimprures, per shkak te forces madhore e per shkak te tjera ligjore.
- 12.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe ne ane te riorganizimit nepermjet formave te thithjes, bashkimit dhe ndarjes.
- 12.3 Gjate fazes se likuidimit te shoqerise administratori ka pergjegjesi.

Rberi.

13. DISPOZITA TE WENDIT.

- 13.1 Viti financiare i shogerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhj-tore. Viti i pare financiare perfundi me 31.12.1994.
- 13.2 Pasuria e shogerise mund te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Shqiperise.
- 15.3 Shoceria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohet nga administratori.

Ky statut u miratua nga administratori sot me dt.17.3.1994

ADMINISTRATORI

Rame Geci

Rame

Republika e Shqiperise
Ministria e Drejtesise

"NOTERIA"

Nr. _____ Rep.

Tirane, me ____./..1994

VERTETIM

Vertetohet se sot u paraqit para meje noterit ne zyren e noterise Tirane, i quajtura Rame Geci i biri i Aliut dhe Pazes, i dtlindjes 2.3.1961, lindur ne Tropjoe dhe bamues ne qytetin e Leqit, lagjen nr,4, pallati 125/1/14 per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi qe mu paraqit.

Para meje, me vullnet te lire firmosi kete statut te shogerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "GECI",

NOTE RE